<p>8. Gjatë kontrollit, Inspektori ka për detyrë:</p> <p>8.1. të ndalojë vënien në treg të produktit biocid për të cilin nuk është lëshuar leja sipas këtij Ligji;</p> <p>8.2. të ndalojë vënien në treg e produktit biocid, i cili është klasifikuar dhe shënuar si kimikat shumë i rrezikshëm dhe për të nuk posedon leje nga organi kompetent për zhvillimin e veprimtarisë dhe nuk respekton vendin e shitjes që i është caktuar me leje;</p> <p>8.3. të ndalojë vënien në treg të produktit biocid, për të cilin nuk është siguruar Lista teknike e sigurisë për kimikate;</p> <p>8.4. të ndalojë vënien në treg e produktit biocid, i cili nuk është klasifikuar, paketuar dhe shënuar sipas kërkesave të këtij Ligji;</p> <p>8.5. të ndalojë vënien në treg e produktit biocid, i cili nuk i plotëson edhe kushtet tjera sipas këtij Ligji;</p> <p>8.6. të ndalojë vënien në treg e produktit biocid, për të cilin nuk posedon Licencën, Miratimin, Autorizimin Lejen e importit ose nuk ka bërë notifikimin e eksportit</p>	<p>8. During the inspection, the inspector is obliged to:</p> <p>8.1. prohibit placing on the market of biocidal products for which no permit has been issued under this Law;</p> <p>8.2. prohibit placing on the market of biocidal product, which has been classified and labeled as very dangerous chemical and not have a permit by the competent authority for the development of activity and disrespects place of sale which is fixed by the permission;</p> <p>8.3. prohibit placing on the market the biocidal products, for which is not provided the Safe Data sheet for chemicals;</p> <p>8.4. prohibit placing on the market the biocidal products which is not classified, packaged and marked according to the requirements of this law;</p> <p>8.5. prohibit placing on the market of a biocidal product which does not fulfill also the other conditions under this law;</p> <p>8.6. prohibit placing on the market of biocidal products, which does not possess a License, Approval, Authorization, or import Permit or has not made a</p>	<p>8. Tokom kontrole, inspektor ima za dužnost da:</p> <p>8.1. zabrani stavljanje u tržište biocidnih proizvoda za koje nije izdata dozvola u skladu sa ovim Zakonom;</p> <p>8.2. zabrani stavljanje u tržište biocidnog proizvoda, koji je klasifikovan i označen kao veoma opasna hemikalija i za to nema dozvolu nadležnog organa za razvoj aktivnosti i ne poštuje odluku prodaje koja je utvrđena dozvolom;</p> <p>8.3. zabrani stavljanje u tržište biocidnih proizvoda, za koje nije osigurana Tehnicki lista za bezbednosti o hemikalije;</p> <p>8.4. zabrani stavljanje u tržište biocidnog proizvoda, koji nije klasifikovan, upakovan i obeležen u skladu sa zahtevima ovog zakona;</p> <p>8.5. zabrani stavljanje u tržište biocidnog proizvoda koji ne ispunjava i druge uslove u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>8.6. zabrani stavljanje u tržište biocidnog proizvoda, za koju ne poseduje licencu, odobrenje, ovlašćenje, dozvolu za izvoz ili nije uradio notifikaciju izvoza ili</p>
---	--	---

<p>ose atë të transitit;</p> <p>8.7. të urdhërojë marrjen e masave tjera për të cilat është i autorizuar me dispozitat e këtij Ligji dhe dispozitat e ligjeve tjera në fuqi.</p> <p>9. Nëse gjatë kontrollit të produktit biocid, konstatohen shkelje ligjore, Inspektori është i obliguar që në kuadër të masave, të shqiptoj gjobë për kundërvajtje sipas nenit 46, të këtij Ligji.</p> <p>KAPITULLI XV- DISPOZITAT NDËSHKUESE</p> <p>Neni 46 Dispozitat kundërvajtëse</p> <p>1. Për shkeljet e dispozitave të këtij Ligji, personat juridikë dënohen për kundërvajtje me gjobe e cila nuk mund të jetë më pak se pesëqind (500) euro, dhe jo më shumë se dyzet mijë (40.000) euro, në rast se:</p> <p>1.1. vendosen në treg apo përdorë substanca aktive apo produkte biocide në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 8, të këtij Ligji;</p> <p>1.2. vendoset në treg të produktit biocid të pa autorizuar duke mos zbatuar nenin 5, paragrafi 1, të këtij Ligji;</p>	<p>notification of export or transit of it;</p> <p>8.7. Orders other measures for which is authorized by the provisions of this law and the provisions of other applicable laws.</p> <p>9. If during the inspection of the biocidal product, are found legal violations, the inspector is obliged under the measures included, to Impose the fine under Article 46 of this Law.</p> <p>CHAPTER XV-PENALTY PROVISIONS</p> <p>Article 46 Misdemenaour provisions</p> <p>1. For violations of the provisions of this Law, legal persons shall be fined for a minor offense, which shall not be less than five hundred (500) euro, and not more than forty thousand (40.000) euro, if:</p> <p>1.1. place on the market or use active substances or biocidal products in violation of Article 4, paragraph 8, of this Law;</p> <p>1.2. placing on the market the biocidal products which is not authorized by violating Article 5, paragraph 1, of this Law;</p>	<p>tranzita;</p> <p>8.7. naredi preduzimanje drugih mera za koju je ovlašćen odredbama ovog zakona i drugim odredbama na snazi.</p> <p>9. Ako se u toku kontrole biocidnog proizvoda, konstantuje kršenje zakona, inspektor je obavezan da u okviru mera, izrekne kaznu u skladu sa članom 46 ovog Zakona.</p> <p>POGLAVLJE XV- KAZNENE ODREDBE</p> <p>Član 46 Prekršajne odredbe</p> <p>1. Za povrede odredaba ovog zakona, pravna lica kažnjavaju se za prekršaj sa kaznom koja nije manja od petsto (500) evra, i ne visa od ceterdesethiljada (40,000) evra, ako:</p> <p>1.1. stavi na tržište ili koristi aktivna supstanca ili biocidni proizvodi u suprotnosti sa članom 4, stav 8 ovog Zakona;</p> <p>1.2. stavi na tržište neovlašćeni biocidni proizvod ne sprovodeći član 5, stav 1, ovog zakona;</p>
--	--	---

<p>1.3. nuk bëhet etiketimi, shënimi, paketimi dhe nuk u lënë në dispozicion Listën me të dhëna për siguri, për produktin biocid, neni 5, paragrafi 10, të këtij Ligji;</p> <p>1.4. produkti biocid vihet në treg ose përdorët në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, paragrafi 4, dhe/ose 5, të këtij Ligji;</p> <p>1.5. vendosen në treg dhe përdorin artikuj të trajtuar në kundërshtim me neni 9, paragrafi 1, të këtij Ligji;</p> <p>1.6. etiketimi i produktit biocid jep shënime të pasakta në kundërshtim me përcaktimet nga neni 9, paragrafi 3 dhe 4, i këtij Ligji;</p> <p>1.7. nuk zbaton kërkesat sipas nenit 9, paragrafi 6 dhe 7, të këtij Ligji;</p> <p>1.8. nuk njofton organin kompetent sipas dispozitave të nenit 10, paragrafi 1, të këtij Ligji,</p> <p>1.9. nëse klasifikimi, paketimi dhe etiketimi i produkteve biocid nuk bëhet në harmoni me nenin 13, të këtij Ligji;</p>	<p>1.3. not labeling, marking, packaging and not given the list with the available safety data for the biocidal product Article 5, paragraph 10 of this Law;</p> <p>1.4. biocidal product placed on the market or used contrary to the provisions of Article 7, paragraph 4 and / or 5 of this Law;</p> <p>1.5. placed on the market and used article treated in violation of article 9 paragraph 1 of this Law;</p> <p>1.6. labeling of biocidal product gives incorrect information in violation of the provisions of article 9, paragraph 3 and 4 of this Law;</p> <p>1.7. It does not comply with the requirements of Article 9, paragraph 6 and 7 of this Law;</p> <p>1.8. do not notify the competent authority under the provisions of Article 10, paragraph 1, of this Law,</p> <p>1.9. if the classification, packaging and labeling of biocidal products is not in accordance with Article 13 of this Law;</p>	<p>1.3. ne uradi etiketiranje, obeležavanje, pakovanje i ne stavi na raspolaganje Listu sa podacima o bezbednosti za biocidni proizvod član 5 stav 10 ovog zakona;</p> <p>1.4. biocidni proizvod stavi na tržište ili koristi u suprotnosti sa odredbama člana 7, stav 4 i /ili 5 ovog Zakona;</p> <p>1.5. stavi na tržište ili koristi tretirani artikal u suprotnosti sa članom 9 stav 1 ovog zakona;</p> <p>1.6. se u toku etiketiranja biocidnog proizvoda daju netačni podaci u suprotnostima sa onim propisanim u članu 9, stav 3 i 4 ovog Zakona;</p> <p>1.7. se ne sprovedu zahtevi prema članu 9, stavu 6 i 7 ovog zakona;</p> <p>1.8. se ne obavesti nadležni organ prema odredbama člana 10 stav 1, ovog zakona,</p> <p>1.9. se klasifikacija, pakovanje i etiketiranje biocidnih proizvoda ne vrši u skladu sa članom 13. ovog zakona;</p>
--	--	--

<p>1.10. nëse gjatë reklamimit të produkteve biocide nuk i përmbahent nenit 14, paragrafi 2, 3 dhe 4, të këtij Ligji;</p> <p>1.11. nëse prodhuesi ose Importuesi nuk sigurojnë Listën me të dhënat mbi sigurinë nga kimikatet e rrezikshme, për produktet biocide dhe substancat aktive, sipas nenit 15, të këtij Ligji;</p> <p>1.12. personi fizik ose juridik i autorizuar apo licencuar që prodhon ose/dhe magazinon ose transporton produkte biocide nuk i përmbushë kushte sipas nenit 16, paragrafi 1, 3 dhe 4 të këtij Ligji;</p> <p>1.13. kur produktet biocide paktohen në atë mënyrë që do të krijojnë konfuzion, paqartësi apo dilema për shfrytëzuesin e tyre sipas nenit 16 paragrafi 2, të këtij Ligji;</p> <p>1.14. transporti dhe ruajtja e produkteve biocide bëhet në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në nenin 16, paragrafi 5, dhe 6, i këtij Ligji;</p> <p>1.15. personat fizikë dhe juridikë kryejnë shërbime me produkte biocide pa marrëveshje dhe nuk përfillin legjislacionin në fuqi dhe normat higjienike - sanitare, dhe mjedisore, si dhe</p>	<p>1.10. if during the advertising of biocide products do not respect Article 14, paragraph 2; 3 and 4 of this Law;</p> <p>1.11. if the manufacturer or importer does not provide List with data on the safety of hazardous chemicals, for biocidal products and active substances under Article 15 of this Law;</p> <p>1.12. authorized natural or legal person, licensed that produces and / or stores, or transports biocidal products does not meet the conditions under Article 16, paragraph 1, 3 and 4 of this Law;</p> <p>1.13. when biocidal products are packaged in a way that will create confusion, uncertainty or dilemma for their users, Article 16 paragraph 2 of this Law;</p> <p>1.14. transport and storage of biocidal products is done in violation of the requirements stipulated in Article 16, paragraph 5 and 6 of this Law;</p> <p>1.15. Natural and legal persons providing services with biocidal products without agreement and in disregard with legislation and hygiene-sanitary norms, as well as environmental, and are not</p>	<p>1.10. se tokom reklamiranja biocidnih proizvoda ne pridržava prema članu 14, stav 2; 3 i 4 ovog zakona;</p> <p>1.11. proizvođač ili uvoznik ne obezbedi Listu podataka o sigurnosti opasnih hemikalija, za biocidne proizvode i aktivne supstance, prema članu 15. ovog zakona;</p> <p>1.12. ovlašćeno pravno ili fizičko lice koji proizvodi ili / i magacionira ili transportuje biocidne proizvode ne ispunjava uslove iz člana 16. stav 1, 3 i 4 ovog zakona;</p> <p>1.13. se biocidni proizvodi pakuju na način koji će stvoriti konfuziju, nesigurnost ili dilemu za svoje korisnike iz člana 16 stav 2 ovog zakona;</p> <p>1.14. se transport i skladištenje biocidnih proizvoda vrši u suprotnosti sa zahtevima opisanih u članu 16. stav 5. i 6. ovog zakona;</p> <p>1.15. pravna i fizička lica vrše usluge sa biocidnim proizvodima bez dogovora i ne poštuju zakonodavstvo na snazi i higijensko-sanitarne propise, kao i one za životnu sredinu, kao i nisu licencirani</p>
---	---	---

<p>nuk janë të licencuar sipas nenit 23, paragrafi 2, të këtij Ligji;</p> <p>1.16. institucionet dhe agjencitë publike të Republikës së Kosovës, brenda kompetencave të tyre, dhe për nevojat e tyre, nuk kontraktjnë personat juridikë për shërbimet me produkte biocide, sipas nenit 23, paragrafi 3, të këtij Ligji;</p> <p>1.17. personi fizik dhe juridik vendas apo i huaj, nuk janë të licencuar për prodhimin e produkteve biocide dhe nuk autorizojnë produktin biocid të tyre neni 24, paragrafi 1 dhe 2, i këtij Ligji;</p> <p>1.18. bartësi i autorizimit nuk siguron, që etiketa të mos jetë çorientuese në lidhje me rreziqet nga produkti biocid për shëndetin e njeriut, shëndetin e kafshëve apo mjedisin apo efikasitetin e tij dhe nuk zbatohen detyrimet sipas nenit 25, paragrafi 1, të këtij Ligji;</p> <p>1.19. përdoruesit e produkteve biocide, gjatë ofrimit të shërbimeve me produkte biocide në mjedis ose shëndetin publik, nuk i përmbushin detyrimet sipas nenit 25, paragrafi 2, të këtij Ligji;</p>	<p>licensed, Article 23 paragraph 2 of this Law;</p> <p>1.16. institutions and public agencies of the Republic of Kosovo, within their competence, and their needs, do not contract legal entities for services with biocidal products, according to article 23 paragraph 3 of this Law;</p> <p>1.17. natural person or legal entity domestic or foreign, are not licensed for production of biocides and biocidal products and do not authorize their biocide Article 24, paragraph 1 and 2 of this Law;</p> <p>1.18. if the authorization holder does not ensure that labels are not misleading with respect to the risks of the biocidal product on human health, animal health or the environment or its efficacy and do not apply the obligations under Article 25, paragraph 1, of this Law;</p> <p>1.19. if users of biocidal products, in providing services to biocide products the environment or public health, do not fulfill their obligations under Article 25, paragraph 2, of this Law;</p>	<p>prema članu 23 stav 2 ovog zakona;</p> <p>1.16. institucije i javne agencije Republike Kosovo, u okviru svoje nadležnosti, i njihove potrebe, ne ugovaraju pravna lica za usluge sa biocidnim proizvodima, u skladu sa članom 23 stav 3 ovog zakona;</p> <p>1.17. domaće i strano pravno i fizičko lice, nije licencirano za proizvodnju biocidnih proizvoda i ne ovlašćuju biocidni proizvod član 24, stav 1 i 2 ovog zakona;</p> <p>1.18. posedilac ovlašćenja ne obezbeđuje, da etiketa bude nedezorjetaciona u vezi sa opasnostima od biocidnog proizvoda na zdravlje ljudi, zdravlje životinja ili životnu sredinu ili njene efikasnosti i ne primenjuju obaveze iz člana 25. stav 1. ovog zakona;</p> <p>1.19. korisnici biocidnih proizvoda, u toku pružanja usluga sa biocidnim proizvodima na životnu sredinu ili javno zdravlje, ne ispunjavaju svoje obaveze iz člana 25. stav 2. ovog Zakona;</p>
--	---	--

<p>1.20. personat që prodhojnë, magazinajnë dhe personat që përdorin substancat aktive, artikullin e trajtuar dhe japin shërbimin me produktet biocide, nuk iu përmbahen kufizimit dhe ndalimit sipas nenit 26, paragrafi 3, të këtij Ligji;</p> <p>1.21. vepron në kundërshtim me nenin 27, të këtij Ligji;</p> <p>1.22. nëse mbajtësit e autorizimit, licencës dhe lejes për import nuk mbajnë dhe ruajnë shënimet sipas nenit 33, paragrafi 1, 2 dhe 3, të këtij Ligji;</p> <p>1.23. nëse mbajtësit e autorizimit, licencës dhe lejes për import nuk raportojnë sipas nenit 33, paragrafi 4, i këtij Ligji;</p> <p>1.24. nuk i përcjell dhe vëzhgon të gjitha efektet e dëmshme, që mund të kenë ndikime të dëmshme në shëndetin e njeriut, kafshëve dhe mjedis, nëse nuk informohen institucionet kompetente dhe shënimet nuk bëhen publike sipas nenit 34, të këtij Ligji;</p> <p>1.25. nëse nuk zbatohen dispozitat e nenit 37, dhe 38, të këtij Ligji;</p>	<p>1.20. persons that producing, storing and people who use active substances, treated articles and provide service with biocidal products do not adhere to the restriction and prohibition under Article 26, paragraph 3 of this Law;</p> <p>1.21. acted in contrary to Article 27 of this Law;</p> <p>1.22. if the holder of the authorization, license and permit for import and store, do not keep data and notes according to the article 33, paragraph 1, 2 and 3 of this Law;</p> <p>1.23. if the holder of the authorization , permission and licenses for import do not report according to Article 33, paragraph 4, of this Law;</p> <p>1.24. does not monitor and conduct survey of all the harmful effects, that can have harmful effects on human health, animals and the environment if not informed the competent institutions and records are not made public under Article 34 of this Law;</p> <p>1.25. if not implement the provisions of Article 37 and 38 of this Law;</p>	<p>1.20. osobe koji proizvode, skladište i osobe koji koriste aktivne supstance, tretirani artikali i pružaju usluge sa biocidnim proizvodima, ne pridržavaju se ograničenja i zabrane prema članu 26 stav 3, ovog zakona;</p> <p>1.21. se postupa u suprotnosti sa članom 27 ovog zakona;</p> <p>1.22. ako posedioci ovlašćenja, licence i dozvole za uvoz ne vode i čuvaju beleške prema članu 33 stav 1; 2 i 3, ovog Zakona;</p> <p>1.23. ako posedioci ovlašćenja, licence i dozvole za uvoz ne izveštavaju prema članu 33 stav 4, ovog zakona;</p> <p>1.24. se ne prati i osmatra sve štetne efekte, koji može imati štetne efekte na zdravlje ljudi, životinja i životne sredine, ukoliko ne obaveštava nadležne institucije i beleške ne čine dostupnim javnosti prema članu 34. ovog Zakona;</p> <p>1.25. se ne sprovode odredbe člana 37 i 38 ovog zakona;</p>
---	--	---

<p>1.26. nëse bartësi i autorizimit, licencës dhe bartësi i lejes për import nuk përgjigjet për dëmet e shkaktuara, neni 41, i këtij Ligji;</p> <p>1.27. kur nuk është përmbushur obligimi përmes kontratës të sigurojë një drejtuesin teknik profesional sipas nenit 42, paragrafi 1, të këtij Ligji;</p> <p>1.28. nëse importi i produkteve biocide, substancave aktive nuk bëhet në përputhshmëri me kushtet e lejes për import, neni 43, paragrafi 1, i këtij Ligji;</p> <p>1.29. nuk prezanton vendimin për leje sipas nenit 43, paragrafi 7, të këtij Ligji;</p> <p>1.30. nëse nuk zbatohen paragrafët 1, 4 dhe 5, të nenit 43, kur produktet sipas paragrafit 8, të nenit 43, gjenden në zonën dhe magazinën doganore.</p> <p>2. Për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik sanksionohet me gjobë për kundërvajtje për shkeljet nga paragrafi 1, i këtij neni, në vlerë prej tridhjetë (30) deri në dymijë (2000) euro.</p> <p>3. Personi që zhvillon biznes individual ndëshkohet për kundërvajtje për shkelje nga paragrafi 1, i këtij neni, me gjobë, në vlerë</p>	<p>1.26. if the holder of the authorization, license and import permit do not respond for damages, Article 41 of this Law;</p> <p>1.27. when it is not fulfilled the obligation by contract to provide a professional technical manager Article 42, paragraph 1, of this Law;</p> <p>1.28. if the import of biocide products, active substances not done in compliance with the permit conditions for import, Article 43, paragraph 1, of this Law;</p> <p>1.29. do not presents permit decision according to the article 43, paragraph 7 of this Law;</p> <p>1.30. if not implement paragraphs 1,4 and 5 of Article 43, when the products under paragraph 8 of Article 43, found in the customs zone and warehouse.</p> <p>2. The natural person and responsible legal entity shall be sanctioned for violations of paragraph 1 of this Article, In the amount of thirty (30) to two thousand (2000) euros.</p> <p>3. The person conducting an individual business shall be sanctioned for offenses for violations referred to in paragraph 1 of this</p>	<p>1.26. posedilac ovlašćenja, licence i dozvole za uvoz ne odgovara za uzrokovane štete, član 41 ovog zakona;</p> <p>1.27. nije ispunjena obaveza po ugovoru da se obezbedi jedan profesionalni tehnički menadžer član 42, stav 1, ovog Zakona;</p> <p>1.28. uvoz biocidnih proizvoda, aktivnih supstanci ne vrši u skladu sa uslovima dozvole za uvoz, člana 43. stav 1. ovog Zakona;</p> <p>1.29. se ne pokaže odluku za dozvolu u skladu sa članom 43. stav 7. ovog Zakona;</p> <p>1.30. se ne sprovode stavovi 1,4 i 5 člana 43, kada proizvodi prema stavu 8 član 43, nalazi u carinskoj zoni skladištu.</p> <p>2. Fizičko lice i fizičko lice u pravnom licu sanksioniše za prekršaje iz stava 1 ovog člana, u iznosu od trideset (30) do dve hiljade (2000) evra.</p> <p>3. Lice koja obavlja samostalnu delatnost sanksioniše za prekršaje iz stava 1 ovog člana, na snazi, u iznosu od dvesta (200) do pet</p>
--	--	--

<p>prej dyqind (200) deri në pesëmijë (5000) euro.</p> <p>4. Sendet që janë përdorë ose kanë qenë të destinuara për kryerjen e kundërvajtjes gjatë zhvillimit të çfarëdo aktiviteti gjatë të cilit kryen shkeljet sipas paragrafit 1, të këtij neni, ose që kanë lidhje me kundërvajtjen e bërë, sekuestrohen, nëse janë pronë e personit që kryen kundërvajtjen, dhe konfiskim i sendit.</p> <p>5. Personi ndaj të cilit shqiptohet ndëshkimi me gjobë është i detyruar që të bëjë pagesën në afat prej pesëmdhjet (15) ditësh nga dita e shqiptimit të gjobës.</p>	<p>Article, in the amount of two hundred (200) to five thousand (5000) euros.</p> <p>4. Items that were used or were intended to commit the offense during the course of any activity, during which commits the violation under paragraph 1 of this Article, or that are related to the offense committed, shall be sequestrated, if they are property of the person who commit the offense, according to the Law on Minor Offences.</p> <p>5. The person against whom the penalty of a fine is imposed, is obliged to make the payment within fifteen (15) days from the date of the fine imposition.</p>	<p>hiljada (5000) evra.</p> <p>4. Predmeti koji su upotrebljeni ili su bili namijenjeni za izvršenje krivičnog dela tokom bilo kakve aktivnosti tokom kojih učini prekršaj iz stava 1. ovog člana, ili su u vezi sa ucinjenim prekršajem, oduzme, ako su vlasništvo lica koje je izvršilo krivično delo, i konfiskacija stvari u skladu sa Zakonom o prekršajima.</p> <p>5. Lice kome se izriče novčana kazna podleže plaćanju u roku od petnaest (15) dana od dana izricanja novčane kazne.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 47 Përcaktimi i masës kundervajtëse</p> <p>1. Me këtë Ligj, të drejtën e shqiptimit të gjobave për kundërvajtje, e ka Organi kundervajtës ose dhe Gjykata. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes paraqitet në Gjykatën kompetente.</p> <p>Procedurat e shqyrtimit dhe shqiptimit të gjobave për kundërvajtje si dhe ankimit në vendimin e Organit kundërvajtjes me rastin e zhvillimit të procedurës së kundërvajtjes për gjobë, bëhen në përputhje me dispozitat, e Ligjit përkatës për Procedurën Administrative.</p>	<p style="text-align: center;">Article 47 Determination of misdemeanor for offense</p> <p>1. By this Law, the right of imposing fines for minor offenses, have the misdemeanor body or court. The request for initiation of the offense procedure is submitted to the competent court..</p> <p>2. The procedures for reviewing and imposing the misdemeanor fines as well as the appeal in the decision of the offense Body on the occasion of the execution of the offense proceedings for fines are made in accordance with the provisions of the relevant Law on</p>	<p style="text-align: center;">Član 47 Određivanje prekršajnih mera</p> <p>1. Ovim zakonom, pravo na izricanje prekršajnih novčanih kazni , Organ za prekršaje I ili Sud. Zahtjev za pokretanje prekršajnog postupka podnosi se nadležnom sudu.</p> <p>2. Postupci za razmatranje i izricanje novčanih kazni za prekršaje, kao i za žalbu na odluku organa za prekršaje u slučaju izvršenja prekršajnog postupka za novčane kazne vrši se u skladu sa odredbama relevantnog Zakona o Upravnom Postupku.</p>

<p>3. Nëse personi paguan gjobën në afat sipas paragrafit 5 nenit 46 të këtij Ligji, paguan vetëm gjysmën (50%) e shumës së gjobës së shqiptuar.</p> <p>4. Dëshminë për pagesë, personi sipas paragrafit 3 të këtij neni, ia paraqet autoritetit kompetent që ka shqiptuar gjobën.</p> <p>5. Nëse personi nuk e paguan gjobën sipas afatit të percaktuar në paragrafit 5, nenin 46 të këtij Ligji, ose nuk parashtron kundërshtim brenda afatit prej tetë (8) ditësh, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për procedurën përmbarimore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 48 Zbatimi i ligjit për procedurën e përgjithshme administrative</p> <p>Nëse me këtë Ligj nuk përcaktohet ndryshe, atëherë zbatohen dispozitat e Ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.</p>	<p>Administrative Procedure.</p> <p>3. If a person pays a fine within the term, according to paragraph 5 of Article 46 of this Law, he pays only half (50%) of the amount of mandatory fines imposed.</p> <p>4. Proof of payment, the person referred to in paragraph 1 of this Article, shall submit to the competent authority who has imposed the fine.</p> <p>5. If the person fails to pay the fine within the time limit set out in paragraph 5, Article 46 of this Law, or does not submit an objection within a period of eight (8) days, the compulsory execution shall be enforced in accordance with the provisions of the Law on Execution Procedure.</p> <p style="text-align: center;">Article 48 Implementation of the law on general administrative procedure</p> <p>Unless this law does not specify otherwise, then are applied the provisions of the Law on general administrative procedure.</p>	<p>3. Ako lice plati kaznu u roku iz stava 5. člana 46. ovog zakona, on plaća samo polovinu (50%) novčane kazne od iznosa obavezne novčane kazne.</p> <p>4. Dokaz o uplati, lice iz stava 1. ovog člana, podnosi nadležnom organu da je izrekao novčanu kaznu.</p> <p>5. Ako lice ne isplati novčanu kaznu u roku iz stava 5, člana 46. ovog zakona ili ne podnese prigovor u roku od osam (8) dana, primarno izvršenje vrši se u skladu sa odredbama Zakona o izvršnom postupku.</p> <p style="text-align: center;">Član 48 Sprovođenje zakona o opštem upravnom postupku</p> <p>Ako se ovim zakonom ne određuje drukčije, tada se sprovode odredbe Zakona o opštem upravnom postupku.</p>
---	--	---

KAPITULLI XVI- DISPOZITA KALIMTARE DHE PËFUNDIMTARE	CHAPTER XVI- TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS	POGLAVLJE XVI- PRELAZNE I KONAČNE ODREDBE
<p style="text-align: center;">Neni 49 Zbatimi i dispozitave nga legjislacioni i kimikateve</p> <p>Nëse me dispozitat e këtij Ligji nuk janë përfshirë çështjet për prodhimtarinë dhe vënien në treg të produkteve biocide dhe për pasojat gjatë përdorimit të tyre, atëherë, në Republikën e Kosovës do të zbatohen dispozitat në fuqi të legjislacionit për kimikate.</p>	<p style="text-align: center;">Article 49 Implementation of provisions by the chemicals legislation</p> <p>If in the provisions of this law are not included the issues of manufacturing and placing on the market of biocidal products and aslo the consequences of their use, then, in the Republic of Kosovo shall apply the provisions of the applicable legislation on chemicals.</p>	<p style="text-align: center;">Član 49 Sprovođenje odredbi iz zakona o hemikalijama</p> <p>Ako se odredbama ovog zakona nisu uključila pitanja o proizvodnji i stavljanju u tržište biocidnih proizvoda i posledice tokom njihovog korišćenja, tada će se u Republici Kosovo primenjivati odredbe važećeg Zakona o hemikalijama.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 50 Nxjerrja e akteve nënligjore</p> <p>Ministria nxjerrë aktet nënligjore të përcaktuara me këtë Ligj brenda gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.</p>	<p style="text-align: center;">Article 50 Issuance of sub-legal acts</p> <p>The Ministry issues sub-legal acts determined by this Law within six (6) months from the day of entry into force of this Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 50 Izdavanje podzakonskih akata</p> <p>Ministarstvo donosi podzakonske akte utvrđena ovim Zakonom u roku od šest (6) meseci od dana stupanja na snagu ovog Zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 51 Shtojcat</p> <p>1. Shtojcat prej 1 deri në 4 janë pjesë përbërëse e këtij ligji:</p> <p>1.1. Shtojca 1: Lista e substancave aktive të referuara në Nenin 25 (a), të Rregullores nr. 528/2012, apo paragrafi 6, neni 7, të këtij Ligji.</p>	<p style="text-align: center;">Article 51 Annexes</p> <p>1. Annexes 1 to 4 of an integral part of this law.</p> <p>1.1. Annex 1: List of active substances referred to in Article 25 (a), of Regulation no. 528/2012, or Paragraph 6, Article 7 of this Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 51 Aneksi</p> <p>1. Dodatak 1 do 4 o sastavni dio ovog zakona.</p> <p>1.1. Aneks 1: Lista aktivnih supstanci referisanih u Članu 25 (a), Uredbe br. 528/2012, ili stav 6, član 7 ovog Zakona.</p>

<p>1.2. Shtojca 2: Llojet e produkteve biocide dhe përshkrimet e tyre të referuara në nenin 2 (1), të Rregullores nr. 528/2012, apo nën paragrafi 1.1, paragrafi 1, nenin 3, të këtij Ligji.</p> <p>1.3. Shtojca 3: Parimet e përgjithshme për vlerësimin e dosjeve për produktet biocide.</p> <p style="text-align: center;">Neni 52 Shfuqizimi</p> <p>1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Ligji për produktet biocide (Ligji Nr. 03/L-119), dhe cdo dispozitë e dalur prej tijë.</p> <p>2. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni behet per Udhëzimit Administrativ Nr. 09-2015, për vënien në treg, regjistrimin dhe importin e produkteve biocide, i cili mbetet në fuqi deri në nxjerrjen e aktit të ri.</p>	<p>1.2. Annex 2: Types of biocidal products and their descriptions referred to in Article 2 (1), of the Regulation no. 528/2012, or sub-paragraph 1.1, paragraph 1, Article 3 of this Law.</p> <p>1.3. Annex 3: General principles for the evaluation of files for biocidal products.</p> <p style="text-align: center;">Article 52 Repeals</p> <p>1. With the entry into force of this Law, the Law on Biocidal Products (Law No.03 / L-119) and any other provision governing the field of biocidal products,</p> <p>2. which is in contravention of the provisions of this Law, is repealed, except the Administrative Instruction No. 09 -2015, for the placing on the market, registration and import of biocidal products which remains in force until the new act is adopted.</p>	<p>1.2. Aneks 2: Vrste biocidnih proizvoda i njihovi opisi referisanih u članu 2 (1), Uredbe br. 528/2012, ili stav 1.1, stav 1, člana 3 ovog Zakona.</p> <p>1.3. Aneks 3: Opšta načela za procenu dosjea za biocidne proizvode.</p> <p style="text-align: center;">Član 52 Ukidanja</p> <p>1. Stupanjem na snagu ovog Zakona, ukida se Zakon o biocidnim proizvodima(Zakon Br. 03/L-119) kao i svaka druga odredba koja uređuje oblast biocidnih proizvoda</p> <p>2. i u suprotnosti je sa odredbama ovog Zakona, osim Administrativnog uputstva br. 09-2015 o stavljanju u promet, registraciju i uvoz biocidnih proizvoda, koji ostaje na snazi sve do donošenja novog akta.</p>
--	---	--

<p align="center">Neni 53 Hyrja në fuqi</p>	<p align="center">Article 53 Entry into force</p>	<p align="center">Član 53 Stupanje na snagu</p>
<p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p align="right">Kadri Veseli</p> <hr/> <p>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p>This Law enters into force fifteen days (15) after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo</p> <p align="right">Kadri Veseli</p> <hr/> <p>The President of the Assembly of the Republic of Kosovo</p>	<p>Ovaj Zakon stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u Službenom Listu Republike Kosovo.</p> <p align="right">Kadri Veseli</p> <hr/> <p>Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>

SHTOJCA 1: Lista e substancave aktive te referuara në nenin 25 (a) të Rregullores nr. 528/2012/UE, apo neni 7, paragrafi 6, i këtij ligji.

Numri KE	Emri/grupi	Kufizimi	Komenti
----------	------------	----------	---------

Kategoria 1 — Substancat e autorizuar si aditivë të ushqimit për njerëz sipas Rregullores (KE) Nr. 1333/2008

200-018-0	Acidi laktik	Duhet të kufizohet përqendrimi në mënyrë që secili produkt biocid nuk duhet të klasifikohet sipas Direktivës 1999/45/EC apo Rregullores (KE) Nr. 1272/2008	E 270
204-823-8	Acetati i natriumit	Duhet të kufizohet përqendrimi në mënyrë që secili produkt biocid nuk kërkon klasifikim sipas Direktivës 1999/45/EC apo Rregullores (KE) Nr. 1272/2008	E 262
208-534-8	Benzoati i natriumit	Duhet të kufizohet përqendrimi në mënyrë që secili produkt biocid nuk duhet të klasifikohet sipas Direktivës 1999/45/EC apo Rregullores (KE) Nr. 1272/2008	E 211
201-766-0	(+)-Acidi taratarik	Duhet të kufizohet përqendrimi në mënyrë që secili produkt biocid nuk duhet të klasifikohet sipas Direktivës 1999/45/EC apo Rregullores (KE) Nr. 1272/2008	E 334
200-580-7	Acidi acetik	Duhet të kufizohet përqendrimi në mënyrë që secili produkt biocid nuk duhet të klasifikohet sipas Direktivës 1999/45/EC apo Rregullores (KE) Nr. 1272/2008	E 260
201-176-3	Acidi propionik	Duhet të kufizohet përqendrimi në mënyrë që secili produkt biocid nuk duhet të klasifikohet sipas Direktivës 1999/45/EC apo Rregullores (KE) Nr. 1272/2008	E 280

Kategoria 2 — Substancat e përfshira në Shtojcën IV të Rregullores (KE) Nr. 1907/2006

200-066-2	Acid askorbik		
232-278-6	Vaj liri		

Kategoria 3 — Acidet e dobëta

Kategoria 4 — Substancat me origjinë natyrore të përdorura tradicionalisht

Vaji natyral	Vaji i livandës		CAS 8000-28-0
Vaji natyral	Vaj mente		CAS 8006-90-4

Kategoria 5 — Feromonet

222-226-0	Oct-1-en-3-ol		
Përzjerja	Feromoni i moleve të rrobave nga pëlhura e trashë		

Kategoria 6 — Substancat e përfshira në Shtojcën I apo I A të Direktivës 98/8/EC

204-696-9	Dioksidi i karbonit	Vetëm për përdorim në bombola të gazit që janë të gatshme për përdorim, të cilat funksionojnë së bashku me një pajisje për kurth	
231-783-9	Nitrogjeni	Vetëm për përdorim në sasi të kufizuara në bombola që janë të gatshme për përdorim	
250-753-6	(Z,E)-Tetradec-9,12-dienyl acetate		

Numri KE	Emri/grupi	Kufizimi	Komenti
----------	------------	----------	---------

Kategoria 7 — Tjera

	Baculovirus		
215-108-5	Bentoniti		
203-376-6	Citronella		
231-753-5	Sulfati i hekurit		
64-17-5	Etanoli		Regulorja (EU) No. 162/2013, e ndryshuar me Shtojcën e Regulores (EC) No. 3199/93,

SHTOJCA 2: Llojet e produkteve biocide dhe përshkrimet e tyre të referuara në nenin 2(1), të regullores Nr. 528/2012/UE, ose sipas paragrafit 1, nenit 2 të këtij ligji

GRUPI KRYESORË 1: Dezinfektuesit

Këto lloje të produkteve nuk përfshijnë produktet për pastrim që nuk prodhohen me qëllim të nxitjes të efektit biocid, përfshirë edhe pastruesit të lëngshëm, detergjentet dhe produktet të ngjashme.

Lloji i produktit 1: Higjiena personale

Produktet biocide për higjienën personale. Prodhimet nga ky grup janë produktet biocide që përdoren për nevojat e higjienës personale të njerëzve

Lloji i produktit 2: Dezinfektuesit jo të destinuar për aplikim të drejtpërdrejtë tek njerëzit apo kafshët

Produktet që përdoren për dezinfektim të ajrit, sipërfaqeve, materialeve, alateve dhe mobileve që nuk janë në kontakt të drejtpërdrejt me ushqimin ose ushqimin për shtazët shtëpiake

Vendet të përdorimit përfshijnë, mes të tjerash, pishinat, akuariumet, ujin për larje dhe ujëra të tjera; sistemet e klimatizimit; muret dhe dyshemetë e institucioneve shëndetësore dhe të tjera; nevojtoret kimike, ujërave të zeza, mbeturinave të spitaleve, tokës dhe substrateve të tjerë.

Produktet që përdoren si dezinfektues për trajtimin e pishinave, akuariumeve dhe ujërave tjerë dhe për sanimin e materialeve të ndërtimit.

Produktet e përdorura për t'u inkorporuar në tekstil, materiale, maska, bojëra tjera ose materiale me qëllim të prodhimit të trajtuara në nene me veti të dezinfektimit.

Lloji i produktit 3: Produktet biocide për higjienë veterinare

Produktet që përdoren për nevojat e higjienës në veterinari të tilla si dezinfektuesit, sapunë dezinfektues, produkte për shëndetin oral dhe trupor me funksion kundër mikrobeve.

Produktet për dezinfektim të materialeve dhe sipërfaqeve lidhur me kujdesin ose transportin e kafshëve.

Lloji i produktit 4: Preparatet dezinfikuese në fushë të ushqimit dhe ushqimit për shtazët

Produktet që përdoren për nevojat e higjienës veterinare të tilla si dezinfektuesit, sapunët e dezinfektimit, produktet e higjienës orale dhe trupore me funksion kundër mikrobeve.

Produktet që përdoren për materialet e mbarështimit e që mund të hyjnë në kontakt me ushqimin.

Lloji i produktit 5: Uji i pijshëm

Produktet që përdoren për dezinfektimin e ujit të pijshëm për njerëzit dhe kafshët.

GRUPI KRYESORË 2: Preparatet për mbrojtje

Nëse nuk shprehet ndryshe, këto lloje të produkteve përfshijnë vetëm produkte për parandalimin e zhvillimit të mikrobeve dhe algave.

Lloji i produktit 6: Konservuesit e produkteve gjatë deponimit

Produktet që përdoren për ruajtjen e produkteve të prodhuara, pos ushqimit dhe ushqimit të kafshëve, kozmetikës ose produktit medicinal ose pajisjes medicinale nga prishja mikrobike për të siguruar jetën e tyre.

Produktet që përdoren si mbrojtës për ruajtjen ose përdorimin e helmeve, insekticideve ose produkteve helmuese tjera.

Lloji i produktit 7: Mbrojtja e mbështjellësit

Produktet që përdoren për mbrojtjen e sipërfaqeve ose mbështjellësve nga kontrolli i prishjes mikrobike apo rritjen e algave për të mbrojtur karakteristikat potenciale të sipërfaqes të materialeve apo objekteve të tilla si ngjyra, plastika, ngjitës, ngjitëse muri, lidhësit, letër, veprat e artit.

Lloji i produktit 8: Konservuesit e drurit

Prodhimet që përdoren për mbrojtje të drurit, nga faza e prerjes në fabrikë, ose prodhimeve të drurit, nga organizmat që deformatojnë dhe shkatërrojnë drurin.

Ky lloj i prodhimeve përfshinë edhe produktet kurative dhe preventive.

Lloji i produktit 9: Preparatet për mbrojtje të indeve penjzore, lëkurës, gomës dhe materialeve polimerie

Prodhimet që përdoren për mbrojtje të indeve pejëzore, ose materialeve polimerie, si që janë lëkura, goma ose letra ose prodhimet nga tekstili dhe goma, prej prishjes mikrobike.

Ky lloj i produktit përfshin prodhimet biocide të cilat armiqësojnë zgjidhjen e mikroorganizmave në sipërfaqen e materialeve dhe për këtë arsye pengojnë ose parandalojnë zhvillimin e aromës dhe/ose ofrojnë lloje tjera të përfitimeve

Lloji i produktit 10: Preparatet për mbrojtje në ndërtimtari

Prodhimet që përdoren për mbrojtje dhe sanimin e mureve dhe materialeve konstruktive, pos drurit, prej prishjes mikrobike dhe sulmit të algave.

Lloji i produktit 11: Konservuesit për ftohjen e lëngjeve dhe sistemin e përpunimit

Preparatet për mbrojtje të ujit dhe lëngjeve të tjera sistemet e klimatizimit dhe instalimeve nga organizmat të dëmshëm si që janë: mikrobet, algat dhe guaskat.

Produktet që përdoren për dezinfektimin e ujit të pijshëm ose për ujin e pishinave nuk janë të përfshira në këtë lloj të produktit

Lloji i produktit 12: Slimicidet

Prodhimet që përdoren për parandalimin ose pengimin e formimit të jargëve në materiale, pajisje dhe sende që përdoren në procese industriale, p.sh. në pulpa të drurit dhe të letrës, në shtresat të depërtueshme zallore te ekstraktimi i naftës.

Lloji i produktit 13: reparatet për mbrojtje të lëngjeve për përpunimin e metaleve

Prodhimet që përdoren për mbrojtje të lëngjeve për përpunimin e metaleve prej prishjes mikrobike.

GRUPI KRYESOR 3: Kontrollimi i insekteve

Lloji i produktit 14: Rodenticidet

Produktet që përdoren për kontrollin e minjve apo brejtësve të tjera, me mjete të tjera të shtytje apo tërheqje

Lloji i produktit 15: Avicidet

Produktet që përdoren për kontrollin e zogjve nëpërmjet mënyrave të tjera përveç shtytjes dhe tërheqjes

Lloji i produktit 16: Moluskicidet

Produktet që përdoren për kontrollin e butakëve, krimbave dhe jovertebrorëve nuk mbulohen nga lloje të produkteve tjera me mjete të tjera përveç shtytjes apo tërheqjes.

Lloji i produktit 17: Preparatet për pengimin e peshqve

Produktet që përdoren për kontrollin e peshqve, nëpërmjet mënyrave të tjera përveç shtytjes dhe tërheqjes

Lloji i produktit 18: Insekticidet, akaricidet dhe prodhimet për pengimin e nyjorëve, si dhe produkte tjera për të kontrolluar antropotëd

Produktet që përdoren për të kontrolluar antropotëd (p.sh. insektet, antropoid i llojit të merimangës ose akrepit dhe krustacet), nëpërmjet mënyrave të tjera përveç shtytjes dhe tërheqjes.

Lloji i produktit 19: Shtytës (preparatet për largimin) dhe karremat

Prodhimet për largimin dhe ndjelljen e organizmave të dëmshëm (pa kurrizoret si pleshtat, kurrizoret si zogjtë), përfshirë dhe prodhime që direkt apo indirekt përdoren për higjienën e njerëzve ose shtazëve.

Lloji i produktit 20: Kontrolli i vertebrorëve tjerë

Produktet e përdorura për kontrollin e vertebrorëve përveç atyre të mbuluara tashmë nga lloje tjera të produktit të këtij grupi kryesor, nëpërmjet mënyrave të tjera përveç repulsionit dhe tërheqjes.

GRUPI KRYESORË 4: Produkte tjera biocide

Lloji i produktit 21: Produkte jo ndotëse

Produktet që përdoren të kontrolluar rritjen dhe vendosjen e organizmave ndotës (mikrobet dhe formave të larta të bimëve dhe shtazëve) për anijet, pajisjet për akua kulturë ose struktura tjera të përdorura në ujë.

Lloji i produktit 22: Lëngjet për balsamim dhe përparim

Prodhimet për dezinfektim dhe konservim të kufomave të njerëzve ose shtazëve, ose pjesëve të tyre.

SHTOJCA 3: Parimet e përgjithëshme për vlerësimin e dosjeve për produktet biocide

1.PËRMBAJTJA

2.Shprehjet dhe përkufizimet

3.Hyrja

4.Vlerësimi

5. Parimet e përgjithshme:

- 5.1. Efekte në shëndetin e njerëzve dhe kafshëve,
- 5.2. Efekte në mjedis,
- 5.3. Efekte në organizmat e synuar;
- 5.4. Efikasiteti;
- 5.5. Përmbledhja;
- 5.6. Konkluzione ;
- 5.7. Parime të përgjithshme;
- 5.8. Efektet mbi shëndetin e njeriut dhe kafshëve;
- 5.9. Efektet në mjedis;
- 5.10.Efektet në organizmat e synuar;
- 5.11.Efikasiteti;
- 5.12.Përmbledhja;

6. Konkluzionet e përgjithshme integruese

SHPREHJET DHE PËRKUFIZIMET

Korrespondenca me kriteret e përcaktuara në nenin 19(1)(b) të rregullores Nr. 528/2012/UE , ose nenit 8, paragrafi 1 të këtij Ligji.

Nëntitujt "Efektet mbi shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve", "Efektet në mjedis", "Efektet në organizmat e synuar" dhe "Efikasiteti" të përdorur në seksionet "Vlerësimi" dhe "Konkluzionet" korrespondojnë ndaj katër kriterëve të përcaktuara në nenin 19(1)(b) të rregullores Nr. 528/2012/UE ose nenit 8, paragrafi 1 të këtij Ligji, si me poshte:

‘Efikasiteti’ korrespondon me kriterin (i): ‘është mjaft efektive’.

‘Efektet mbi organizmat e synuar korrespondojnë me kriterin (ii): "nuk ka efekte të dëmshme mbi organizmat e synuar, në veçanti efekte të papranueshme apo rezistencë kryq apo vuajtje të panevojshme dhe dhimbje për vertebrorë’.

"Efektet mbi shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve" korrespondon me kriterin (iii): "nuk ka efekte të papranueshme të menjëhershme apo të vonuara vetë, ose si rezultat i mbetjeve të saj, në shëndetin e njeriut, duke përfshirë atë të grupeve të rrezikuara (1), ose shëndetin e kafshëve, direkt ose nëpërmjet ujit të pijshëm, ushqimit të kafshëve, ajrit, ose nëpërmjet efekteve të tjera indirekte".

‘Efektet në mjedis korrespondon me kriterin IV: "nuk ka efekte të papranueshme në vetvete, ose si rezultat i mbetjeve të saj, në mjedis, duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë konsideratat e mëposhtme:

- Fati dhe shpërndarja e saj në:

7. ndotja e ujërave sipërfaqësore (duke përfshirë derdhjen e lumenjve dhe detit), ujërave nëntokësore dhe ujërave të pijshëm, ajrin dhe tokën, duke marrë parasysh vende të largëta nga përdorimi në distancë të largët të transportit mjedisit,

8. ndikimi në organizmat jo të synuar,

9. ndikimi në biodiversitetin dhe ekosistemin’.

Përkufizime teknike

(a) Identifikimi i rreziqeve

Identifikimi i efekteve të dëmshëm që mund të shkakton prodhimi biocid.

(b) Doza (përqendrimi) — reaksionet (efekti)

Përcaktimi i relacioneve ndërmjet dozës dhe nivelit të ekspozimit ndonjë substance aktive ose substancës e dyshimtë në prodhimin biocid dhe lajmërimin dhe intensitetit të efektit.

(c) Përcaktimi i ekspozimit

Përcaktimi i emisionit, formës dhe shpejtësisë të përhapjes substancës aktive ose substancës të dyshimtë në prodhimin biocid dhe transformimin e saj ose dekompozimin për ta vlerësuar përqendrimi/dozat, cilit/cilëve popullsia njerëzore, shtazët ose pjesët e mjedisit janë ose mund të janë të ekspozuar.

(d) Karakteristikat e rrezikshmërisë

Përcaktimi i lajmërimin dhe forcës të efekteve të dëmshme lajmërimi i të cilëve është i pritur në popullsi njerëzore, të shtazët ose në pjesë e mjedisit për shkak të ekspozimit momental ose paraparë substancës aktive ose substancave të dyshimta në produkte biocide. Këtu mund të përfshihet edhe përcaktimi i rrezikut, ose kuantifikimi i gjasave.

(e) Mjedisi

Ujërat, përfshirë sedimentet, ajrin, tokën, llojet e egra të faunës dhe florës, dhe relacionet mes tyre, si dhe relacionet me organizmat të gjallë.

HYRJE

1. Kjo shtojcë përcakton parimet e përbashkëta për vlerësimin e dosjeve për produktet biocide të përmendura në nenin 19 (1) (b) të rregullores Nr. 528/2012/UE or neni 8 paragrafi 1 I ketij Ligji. Një vendim nga një Shtet Anëtar ose Komisioni për lejimin e produktit biocid do të merret në bazë të kushteve të përcaktuara në nenin 19 të rregullores Nr. 528/2012/UE të rregullores Nr. 528/2012/UE, duke marrë parasysh vlerësimin e kryer sipas kësaj shtojce. Udhëzime të hollësishme teknike lidhur me zbatimin e kësaj shtojce janë në dispozicion në faqen e internetit të Agjencisë.
2. Parimet e përcaktuara në këtë shtojcë mund të zbatohen në tërësinë e tyre në vlerësimin e produkteve biocide të përbëra nga substanca kimike. Për produkte biocide që përmbajnë mikroorganizmat, këto parime duhet të zhvillohen më tej në udhëzim teknik duke marrë parasysh përvojën praktike të fituar, dhe të zbatohen duke marrë parasysh natyrën e produktit dhe informacionet e fundit shkencore. Në rastin e produkteve biocide që përmbajnë substanca shumë të vogla kimike, parimet e përcaktuara në këtë shtojcë do të duhet të përshtaten dhe të përpunohet në drejtimin teknik për të marrë parasysh informacionin e fundit shkencorë.
3. Për të siguruar një nivel të lartë dhe të harmonizuar të mbrojtjes së shëndetit të njeriut, shëndetit të kafshëve dhe mjedisin, çdo rrezik që shkaktohet nga përdorimi i produktit biocid duhet të identifikohet. Për të arritur këtë, një vlerësim i rrezikut duhet të kryhet për të përcaktuar pranueshmërinë ose ndryshe rreziqet që janë të identifikuara. Kjo është bërë duke kryer një vlerësim të rreziqeve lidhur me përbërësit e rëndësishëm të produktit biocid, duke marrë parasysh çdo efektet grumbullues dhe sinergjik.
4. Gjithmonë kërkohet vlerësimi i rrezikut për substancat aktive të pranishme në

produktin biocid. Ky vlerësim i rrezikut do të përfshijë identifikimin e rrezikut, dhe sipas nevojës dozën (përqendrimin) - reagimin (efektin) vlerësimin i ekspozimit dhe karakterizimin i rrezikut. Kur vlerësimi sasior nuk mund të bëhet një vlerësim kualitativ duhet të vlerësohet.

5. Vlerësimet shtesë të rrezikut duhet të kryhen, në të njëjtën mënyrë siç përshkruhet më sipër, në çdo substance të dyshimtë që gjenden në prodhimin biocid. Informacioni i paraqitur në kuadër të rregullores (KE) nr. 1907/2006 do të merret parasyshtë kur është e nevojshme.
